



Ne baze të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008”, e në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1 pika 1.2 lidhur me nenin 14, paragrafi 1, dhe 3, të Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.10/2019”, e konform nenit 5, paragrafi 1, pika 1.3, lidhur me nenin 6 paragrafi 3 dhe nenit 13 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe nenit 15 lidhur me nenin 29, pika 2 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë 28.03.2024, miraton këtë:

## V E N D I M

### Neni 1

**JEPET PËLQIMI**-për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë deri në 99, (nëntëdhjetë e nëntë) vite të pronës së paluajtshme të Komunës si më poshtë;

**Parcela P-72116046-01211-0**, me sipërfaqe të përgjithshme prej: **2943m<sup>2</sup>**, sipas certifikatës së pronës Nr. 1003/2024 të datës 12.03.2024, zona kadastrale Suharekë, vendin i quajtur “**Pojata**”, e evidentuar në emër të Komunës së Suharekës. Nga sipërfaqja e përgjithshme e cekur më lart ndahen për dhënien në shfrytëzim **688m<sup>2</sup>**, për ndërtimin e objektit afarist banesore, me destinim sipas Hartës zonale të Komunës së Suharekës.

### Neni 2

**OBLIGOHET**-Drejtoria për shërbime pronësore juridike dhe kadastër, Drejtoria për urbanizëm dhe planifikim dhe zyra e prokurimit që në bashkëpunim me komisioni për zbatimin procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, afatshkurtër dhe afatgjatë, që të zhvilloj procedurat e konkurrimit të hapur, konform dispozitave të Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.10/2019” dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

### Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

## KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË

01-Nr- 016-18863

Më datë 28.03.2024



Kryesuesi i Kuvendit

Mr. ec Bexhet KUÇI